

URDHËR
Nr. 87, datë 16.5.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME
PËR HARTIMIN E LISTËS SË ADMINISTRATORËVE TË PASURISË SË
SEKUESTRUAR**

Në mbështetje të nenit 104, pika 2, të Kushtetutës; të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 9, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara harton listën e administratorëve të pasurisë së sekuestruar, duke u bazuar në kriteret dhe rregullat e përcaktuara në këtë urdhër.

2. Administrator i pasurisë së sekuestruar mund të caktohet shtetasi shqiptar që përmbush kushtet e mëposhtme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- ç) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

d) të mos jetë larguar nga detyra ose të mos i jetë hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore;

dh) të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë profesionale me kohë të plotë, pas përfundimit të studimeve, në fushën e administrimit të shoqërive tregtare, kontabilitetit, jurisprudencës dhe administrimit të pasurive të paluajtshme ose, përjashtimisht, në fusha të tjera të posaçme që mund të jenë të nevojshme për shkak të nevojës për të administruar pasuri të caktuara. Për qëllime të kësaj pike, eksperiencia në fushën e administrimit të shoqërive tregtare përfshin punën në pozicionin e administratorit të një shoqërie tregtare, drejtor departamenti ose drejtorie i cili, nëpërmjet punës së tij, ka pasur mundësi të ndikojë në procesin vendimmarrës të shoqërisë, si dhe çdo eksperiencë punë në sektorin publik që ka kontrolluar ose mbikëqyrur veprimtarinë e shoqërive tregtare. Eksperiencia e punës në administrimin e pasurive të paluajtshme përfshin çdo pozicion pune në drejtoritë ose sektorët e shërbimeve mbështetëse të institucioneve publike që ka pasur përgjegjësi në administrimin e pasurive publike, si dhe çdo eksperiencë pune në sektorin privat që ka qenë përgjegjës për administrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërisë përkatëse;

e) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare dhe të ketë kualifikime profesionale, të nevojshme për administrimin e kujdesshëm të pasurive të sekuestruara;

ë) të mos ketë qenë ortak apo anëtar i një organi drejtues ose kontrollues apo administrator i një shoqërie, për të cilën janë hapur procedurat e falimentimit dhe/ose të një banke/dege të një banke të huaj të vendosur në likuidim në pesë vitet e fundit. Afati 5-vjeçar fillon nga data e vendimit të organit kompetent për hapjen e procedurave të falimentimit ose të likuidimit;

f) të mos ketë qenë në pesë vitet e fundit ortak apo anëtar i një organi drejtues ose kontrollues, administrator i një shoqërie, për të cilën janë vendosur procedurat e sekuestrimit ose të konfiskimit, në kuadër të një procedimi penal ose administrativ. Afati 5-vjeçar fillon nga data e njoftimit të aktit nga organi kompetent për vendosjen e procedurave të sekuestrimit ose konfiskimit;

g) të mos ketë pasur në pesë vitet e fundit pozicione drejtuese apo kontrolluese në një shoqëri tregtare ose institucion financiar, të cilit i është hequr e drejta për të ushtruar një veprimtari të caktuar tregtare brenda apo jashtë vendit.

3. Përjashtimisht, kur lind nevoja për administrimin e një veprimtarie ekonomike ose pasurie të sekuestruar të veçantë, kryeadministratori krijon një komision të veçantë, i cili është përgjegjës për

të propozuar një fushë tjetër të posaçme, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën “dh”, të pikës 2, të këtij urdhri.

4. Procedura e pranimit në listën e administratorëve të pasurive të sekuestruara realizohet në dy faza, në fazën paraprake të verifikimit të kriterëve specifike dhe në fazën e konkurrimit.

5. Shpallja e procedurës së pranimit kryhet nga kryeadministratori në faqen zyrtare të Agjencisë dhe të Ministrisë së Brendshme tij, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit.

6. Shpallja mbahet në faqet zyrtare për të gjithë kohën deri në emërimin përfundimtar.

7. Shpallja në faqet zyrtare përmban të paktën këto të dhëna:

a) numrin e kandidatëve fitues që do të pranohen në listën e administratorëve të pasurive të sekuestruara;

b) përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës;

c) kriteret e përgjithshme;

ç) kërkesat specifike të pranimit;

d) dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave;

dh) mënyrën e shqyrtimit dhe shpalljen e rezultateve të seleksionimit paraprak;

e) datën për paraqitjen e aplikimit;

ë) datën e zhvillimit të konkurrimit;

f) datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak;

g) datën për shpalljen e rezultateve për vlerësimin përfundimtar;

gj) mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim;

h) mënyrën e njoftimit/komunikimit me aplikantët.

8. Aplikimi për konkursin duhet të paraqitet brenda një periudhe të paktën 15-ditore nga momenti fillestar i shpalljes në faqet zyrtare.

9. Brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi, AAPSK-ja bën verifikimin paraprak të dosjeve të aplikantëve nëse plotësojnë kriteret specifike, të përcaktuara në këtë urdhër. Në përfundim të këtij afati, AAPSK-ja shpall në ambientet e tij dhe në faqet zyrtare listën e kandidatëve që plotësojnë këto kriteret për t’iu nënshtruar konkursit, duke i renditur ata sipas rendit alfabetik.

10. Kandidatët që nuk kanë plotësuar kriteret specifike, njoftohen nga AAPSK-ja dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë kësaj agjencie për t’u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen në AAPSK, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e listës, sipas pikës 9 të këtij urdhri. AAPSK-ja duhet të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

11. Me përfundimin e shqyrtimit të ankesave, AAPSK-ja shpall listën e kandidatëve që do t’i nënshtrohen procedurës së konkurrimit.

12. Faza e konkurrimit konsiston në:

a) vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore;

b) testimi me shkrim;

c) intervistën e strukturuar me gojë.

13. Testimi me shkrim dhe intervista me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, të aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën e kompetencës. Vlerësimi kryhet nga një Komision i Posaçëm i ngritur me urdhër të Kryeadministratorit.

14. Të paktën 2 (dy) ditë përpara zhvillimit të konkurrimit, Komisioni i Posaçëm përgatit pyetjet e testit me shkrim dhe me gojë, duke pasur në konsideratë fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

15. Vlerësimi maksimal është 100 pikë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas një procedure që përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e mëposhtme:

a) vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që përfshin në vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore, 10 pikë;

b) testimi me shkrim, 40 pikë;

c) intervistën e strukturuar me gojë, 50 pikë.

16. Komisioni i posaçëm merr vendim për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve sipas numrit të pikëve.

17. Secili prej anëtarëve jep vlerësimin e tij individual për secilin kandidat. Vlerësimi për secilin kandidat llogaritet si mesatare e pikëve të vendosura nga secili prej anëtarëve.

18. Komisioni i posaçëm shpall listën e kandidatëve fitues të renditur me mbi 70 pikë dhe renditjen e tyre duke filluar nga ai me më shumë pikë.

19. Vendimi merret jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga përfundimi i procedurës së konkurrimit. Lista e fituesve shpallet në faqet zyrtare dhe në ambientet e AAPSK-së. Kandidatët që nuk janë shpallur fitues njoftohen nga AAPSK-ja dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë këtij departamenti për t'u njohur me rezultatet e tyre.

20. Kandidatët me pikë të barabarta renditen sipas këtyre kritereve:

a) në rast se njëri prej kandidatëve përfshihet në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, atëherë ai përzgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër;

b) në rast se kandidatët janë të gjinive të ndryshme atëherë renditja bëhet duke u renditur i pari kandidati që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar në listën e administratorëve të pasurive të sekuestruara;

c) në rast se nuk mund të aplikohet asnjëra nga alternativat e mësipërme, atëherë renditja e kandidatëve me pikë të barabarta bëhet nëpërmjet shortit.

21. Pa cenuar të drejtën e ankimit gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi, kandidatët kanë të drejtë që të ankohen me shkrim pranë kryeadministratorit, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e rezultatit, sipas pikës 19 të këtij urdhri. Kryeadministratori krijon një komision tjetër të veçantë, me jo më pak se tre anëtar, i cili shqyrton ankesat dhe merr vendim, brenda 5 (pesë) ditëve dhe, kur është rasti, bën korrigjimin e listës së fituesve të shpallur sipas pikës 19 të këtij urdhri. Vendimi dhe, kur është rasti, lista e korrigjuar, shpallet menjëherë në faqet zyrtare dhe në ambientet e AAPSK-së.

22. Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 323, datë 2.10.2020, "Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për hartimin e listës së administratorëve të pasurive të sekuestruara, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara", shfuqizohet.

23. Ngarkohet Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla